

Deklarata e pjesëmarrësve të Konferencës së OSBE-së për Media në Evropën Juglindore për të shtënën ndaj gazetares Olivera Lakiç

Ne, pjesëmarrësit e Konferencës së OSBE-së për Media në Evropën Juglindore, që po zhvillohet në Strugë më 10 dhe 11 maj 2018, dënojmë ashpër të shtënën ndaj Olivera Lakiç, gazetares hulumtuese të gazetës ‘Vijesti’ në Mal të Zi, në mbrëmjen e 8 majit 2018.

Nga këtu dërgojmë mbështetje dhe solidaritet për gazetaren Olivera Lakiç, për punonjësit e gazetës ‘Vijesti’, si dhe të gjithë gazetarët dhe punonjësit e mediave që përballen me sulme dhe kërcënime në Mal të Zi, si dhe në rajonin e Evropës Juglindore. Kujtojmë se ky incident nuk është një dukuri e izoluar: ndaj znj. Lakiç kishte kërcënime të tmerrshme në vitin 2011, ajo po ashtu u rrah gjashtë vjet më parë, ndërsa ka pasur njëzet e pesë sulme dhe kërcënime kundër gazetarëve të gazetës “Vijesti”, si dhe ndaj punonjësve dhe pronës së mediave që nga viti 2007. Duam të theksojmë se shumë gazetarë dhe punonjës të medias në të gjithë rajonin e Evropës Juglindore përballen çdo ditë me sulme, përfshi kërcënime fizike dhe kërcënime në internet.

Megjithatë, shumë raste kanë kaluar pa u ndëshkuar dhe shumë nga autorët e krimeve kundër gazetarëve dhe punëtorëve të medias në rajon asnjëherë nuk janë sjellë para drejtësisë. Vërejmë se autoritetet shtetërore kanë hapur hetim për të shtënën ndaj znj. Lakiç dhe se udhëheqësit politikë – në veçanti Presidenti, Kryeministri dhe Kryetari i Parlamentit - e kanë dënuar publikisht sulmin.

Ne u bëjmë thirrje autoriteteve shtetërore të Malit të Zi që të sigurojnë se hetimi për të shtënën ndaj znj. Lakiç është i pavarur, efektiv dhe i shpejtë dhe se autorët e sulmit, përfshi organizatorët e saj, do të sillen para drejtësisë. Politikanët dhe zyrtarët publikë nuk duhet të krijojnë një mjedis armiqësor për mediat përmes deklaratave dhe veprimeve të tyre. Ata duhet të demonstrojnë një nivel më të lartë tolerance për gazetarinë kritike dhe të mbështesin një pluralizëm zërash dhe mendimesh në një shoqëri. Të gjithë subjektet shtetërore dhe jo-shtetërore duhet të pranojnë se çdo sulm ndaj një gazetari jo vetëm që shkel të drejtat e gazetarit në fjalë, por gjithashtu minon “të drejtën e publikut për t’u informuar”, sundimin e ligjit, si dhe vetë demokracinë.

10 maj 2018